

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

QuantX IT Solutions

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

M31904013D

NUIS/NIPT

Rruga e Dibres , Njesia administrative Nr 8 Tirane, Vila nr.153, Kati i Pare zona kadastrale nr 8360

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0672073031

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

info@quantx.al

E-mail

Administrator Dorjana Mehmeti

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2023/08/29

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

0672073031

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-76141-07-26-2023

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open INT

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Sh.A Posta Shqiptare

Vlera e përlogaritur e prokurimit

Vlera e përlogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

70000000

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Blerje pajisje Informatike (Kompjuter, Printer multifunksional, Printer termik, Printer traktor, Fotokopje A4 me ngjyra, Palmar, Monitor televizori, Barcod Reader)

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2023/08/31

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2023/08/31

Numri i njoftimit

Kodi CPV

CN/56784/07262023

30237200-1

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

? Ligji 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (LPP)

? VKM nr.285 datë 19.05.2021 “RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK (RrPP)

? Jurisprudencë: Vendimi i Gjykatës Europiane të Drejtësisë: Çështja C-368/10 “Komisioni European vs. Mbretëria e Holandës”

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavlefshmërinë)

- Tjetër

□

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

Shoqëria QuantX IT Solutions është një shoqëri tregtare e themeluar dhe organizuar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti shitblerje, konsulencë dhe ekspertizë në fushën e pajisjeve elektronike, kompjuterike, softuerike, IT/ ICT.

Si një shoqëri tregtare ofrojmë mallrat dhe shërbimet tona edhe në fushën e prokurimit publik duke paraqitur një interes të vecantë në fushën e ofrimit të produkteve cilësorë të IT dhe zgjidhje inovative me vizionin e qartë për përmirësimin e shërbimeve publike.

Autoriteti Kontraktor (AK) Posta Shqiptare sh.a, për nevojat e tij ka shpallur në portalin e prokurimit publik të APP, procedurën e prokurimit të llojit “Procedurë e hapur” me nr : REF-76141-07-26-2023, me objekt “Blerje pajisje Informatike (Kompjuter, Printer multifunksional, Printer termik, Printer traktor, Fotokopje A4 me ngjyra, Palmar, Monitor televizori, Barcod Reader)” me fond limit 70.000.000 (shtatëdhjetë milion) lekë pa TVSH.

Shoqëria QuantX IT Solutions shpk është një shoqëri e interesuar për të ofertuar në këtë procedurë dhe po përgatit dokumentacionin teknik, ligjor, ekonomik dhe financiar konform kriterëve të tenderit.

Me qëllim qartësimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike, për të patur një panoramë të qartë të detyrave që duhet të përmbushim si operator ekonomik, në bazë të nenit 75 të LPP kemi ushtruar kërkesë për sqarim në datën 23/08/2023 ora 11.09, përmes SPE.

Referuar nenit 75 të LPP, pika 1, paragrafi i dytë, duhet që AK të përgjigjet brenda afatit 3 ditor ndaj kërkesave për sqarim.

Aktualisht edhe pas 6 ditësh, ende nuk kemi një përgjigje nga ana e AK, fakt i cili na legjitimon të ushtrojmë ankim sipas LPP.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Pika 1.

Në SPE kemi paraqitur kërkesë për sqarim në datën 23/08/2023 për të cilën ende nuk kemi asnjë reagim nga ana e AK, megjithëse është e drejtë dhe detyrë e tij të përgjigjet ndaj kërkesave për sqarim nga operatorët ekonomikë të interesuar.

Theksojmë se në bazë të nenit 21 të LPP, citoj:

Neni 21

Autoriteti ose enti kontraktor

1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Është përgjegjësi e AK prokurimi i fondeve publike sipas kornizës ligjore në fuqi dhe pikërisht edhe sqarimi i OE të interesuar është pjesë e kësaj përgjegjësie.

Nga ana tjetër, duke qenë se AK në fjalë është edhe përfituesi direkt i objektit të kontratës që kërkohet të prokurohet, nuk ka asnjë kuptim fakti që AK nuk denjon të sqarojë OE e interesuar më qëllimin e vetëm që të jenë transparente dhe të qarta të gjitha kërkesat/specifikimet për mirërealizimin e kontratës publike.

Theksojmë që sqarimi dhe pasja e një panorame të qartë të kërkesave të AK dhe detyrave që duhet të përmbushë OE, janë pjesë e transparencës në fushën e prokurimit publik, pasi përmes transparencës nuk garantohet vetëm integriteti i vlerësimit të ofertave por edhe mirëmenaxhimi i fondeve publike.

Prandaj duhet që AK, si fillim të ndërmarrë masa për pezullimin e afatit për paraqitjen e ofertave, sqarimin shterues të kërkesave për sqarim, në mënyrë që në një moment të dytë të vijohet me hapat e tjerë të prokurimit.

Këkesa 1 :

Të pezullohet afati për paraqitjen e ofertave deri në sqarimin e plotë të kërkesave tonë dhe të vendoset një afat i ri për paraqitjen e ofertave.

Pika 2.

Duke qenë se nuk u kthye një përgjigje të kërkesës për sqarim mbi specifikimet që kemi paraqitur, po paraqesim kërkesë që këto specifikime të hiqen, pasi më shumë shërbejnë për të keqinformuar operatorët sesa për realizimin optimal të kontratës.

Konkretisht:

Referuar DST-se procedures dhe konkretisht Shtojca 7: FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT , pika 2.3, Aftësitë teknike dhe profesionale, pika 2.3.6: kerkohet si me poshte citoj:

2.3.6. Për Integrimin e platformës së produktit Palmar me platformën e menaxhimit në Cloud, ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacionin që vërteton integrimin e tyre. Në rast se janë produkte nga prodhues të ndryshëm, ofertuesi duhet të paraqesë vërtetim nga secili prodhues për integrimin e tyre.

Mos paraqitja e vërtetimeve nga prodhuesit është kusht për skualifikim.

Referuar Shtojtes 5 : FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE, eshte kerkuar :

1. Kompjuter eshte specifikuar kerkesa :

Të përfshirë: Platformë per menaxhim në distancë.

Ndersa tek Zeri 6 Palmar eshte specifikuar : Platforme Duhet te jete sherbim ne Cloud (SaaS)

Referuar kerkeses 2.3.6 te kerkuar nga AK verejme se eshte nje kerkesese qe nuk ka kuptim referuar dhe specifikimeve teknike per zerin 6.Palmar.

Pra kerkohet ..Integrimi i platformes se produktit Palmar me platformen e menaxhimit ne Cloud.

Referuar dhe kerkesave te Shtojtes 5, mos AK KA DASHUR TE SHPREHET:

Për Integrimin e platformës se menaxhimit ne distance te kompjuterave me platformën e menaxhimit ne Cloud te produktit Palmar, ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacionin që vërteton integrimin e tyre.

Kjo me arsyetimin per unifikimin e te gjitha pajisjeve Kompjuter, Palmar te kerkuara ne kete objekt, ne nje qender te vetme te kontrolli dhe menaxhimi.

Kërkesa 2:

Kërkojmë heqjen pikas te Shtojtes 7:

2.3.6. Për Integrimin e platformës se produktit Palmar me platformën e menaxhimit ne Cloud, ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacionin që vërteton integrimin e tyre. Në rast se janë produkte nga prodhues të ndryshëm, ofertuesi duhet të paraqesë vërtetim nga secili prodhues për integrimin e tyre.

pasi është e paqartë dhe konfuze vendosja e tyre në këtë procedurë prokurimi dhe si me poshte cfare ka kerkuar AK”

6. PALMAR

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE

Processor: Min Octa - Core min 1.8 GHz

RAM: Min 3 GB RAM

SIM Card Min 1 x Nano SIM

Memorie e Brendëshme Internal Memory : Min 32 GB Flash memory

Slot per rritje memorje Min 128GB micro SD slot e suportuar

Display: Min 5 inch color WVGA (1280 x 720);

LED backlight;

Corning Gorilla Glass

Audio Speaker - 1 Watt (94dBA)

Voice support (Internal speaker/microphone)

Sensor Accelerometer (3-axis), ambient light sensor, proximity sensor

Skanimi Min 1D/2D

Bateria Battery : Min 3300 mAh

Kamera mbrapa Min 13 MP

KOMUNIKIMI & MENAXHIMI

Wireless 802.11a/b/g/n; Bluetooth min. V 5.0
 Mbyllje hermetike IP67
 Specifikimet e renjes Min 300 renie ne lartesi 0.5 m
 Siguria WEP (40 or 104 bit); WPA/WPA2 Personal (TKIP dhe AES); WPA3 Personal (SAE);
 WPA/WPA2 Enterprise (TKIP dhe AES); WPA3 Enterprise (AES) ? EAP-TTLS (PAP, MSCHAP,
 MSCHAPv2), EAP-TLS, PEAPv0- MSCHAPv2, PEAPv1-EAP-GTC, LEAP dhe EAP-PWD;
 WPA Enterprise 192-bit Mode (GCMP-256) - EAPTLS; Enhanced Open (OWE)
 Sistemi i Operimit Min I azhornueshem ne Android 14
 Teperfshire Platforme Menaxhimi ne Cloud (SaaS)
 Temperatura e Operimit -10? C to 50? C
AKSESORËT
 Ushqyesi Recharger : Po
 Pesha Jo me shum se 240 g
GARANCIA 1 Vjet garanci nga prodhuesi
 Platforme Duhet te jete sherbim ne Cloud (SaaS)
 Funkcionet kryesore
 dhe licencimi Platforma e ofruar duhet te jete një zgjidhje qe ofron menaxhim te unifikuar për pajisjet Palmar.
 Platforma te jete e licencuar për pajisje Palmar përfshirë te gjitha funksionet e kërkuara.
 Zgjidhja duhet të mundësojë instalim softwari te ri apo upgrade te Palmareve.
 Zgjidhja te mundesoje menaxhimin njekohesisht te sisteme te ndryshem.
 Konfigurim Zgjidhja duhet të mundësojë dispozitat si më poshtë për platformat Andoid.
 Migrimi i Integruar të gjendjes të përdoruesëve.
 Instalimi i automatizuar i programeve ne Android.
 Funksionet dhe veçoritë e platformës Te ofrojë mundësi te thjeshtë për te pare detajet e një pajisje te selektuar duke shfaqur te dhëna mbi klientët e lidhur, pajisjet fqinje, alarmet dhe aktivitet e lidhura me to.
 Te jete e integrueshme me platformen e menaxhimit te pajisjeve kompjuter.
 Zgjidhja duhet të sigurojë Automatizimin e Procesit.
 Zgjidhja duhet të mundësojë nderfaqe grafike per administim nepermjet shfletues internet.
 Zgjidhja duhet të mundësojë raporte e paracaktuara dhe të personalizueshme të bazuara në internet.
 Menaxhimi dhe administrimi Te përdori model te bazuar ne role për akses administratori.
 Te ofroje menaxhim sipas nevojave.

Referuar AK tek specifikimet teknike te zerit Palmar eshte kerkuar:

Teperfshire Platforme Menaxhimi ne Cloud (SaaS)

Konfigurim Zgjidhja duhet të mundësojë dispozitat si më poshtë për platformat Andoid.
 Migrimi i Integruar të gjendjes të përdoruesëve.
 Instalimi i automatizuar i programeve ne Android.

Ne asnje specifikim nuk eshte specifikuar cfare platforme ka PALMARI(KERKESA PER SQARIM KETE KERKON),qe do te integrohet me platformen Coud(SaaS).

Kjo eshte arsya qe AK ka vendosur kriteret kualifikimi te paqartesuara dhe evazive qe te cojne ne nje ofertim jo 100% te ofertave teknike.

Në praktikat e prokurimit publik, duhet të shmangen kriteret/specifikimet që krijojnë kufizime në konkurrencë dhe duhet një studim tregu i mirëfilltë se çfarë kapacitetesh kanë operatorët në treg në raport edhe me nevojat e AK.

AK duhet të ketë parasysh në cdo rast se parimet e LPP, si pjesëmarrja e gjerë, konkurrenca mes operatorëve ekonomikë dhe integriteti i procedurës së prokurimit, janë postulate të padiskutueshme të integritetit dhe besimit në procedurat e prokurimit publik.

Dispozitat më poshtë, e parashikojnë në mënyrë eksplicite se çfarë duhet të ketë parasysh AK:

Neni 2

Qëllimi

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3

Parime të përgjithshme

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Neni 21

Autoriteti ose enti kontraktor

1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Neni 87

Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

4. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

Dhe neni 45 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK, citoj;

Neni 45

Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

6. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit, të verifikohen, për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoriteti/enti kontraktor verifikon saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

Po ashtu vendosja e këtyre kriterëve përbën një shkelje të Kodit të Procedurave Administrative në RSH, neni 13, neni 14, citoj:

Neni 13

Parimi i drejtësisë dhe i paanësisë

Në ushtrimin e funksioneve të tij, organi publik trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie.

Neni 14

Parimi i objektivitetit

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative.

Autoritet Kontraktore duhet të marrin parasysh që procedurat e tenderit duhet të jenë të formuluar në një formë që të nxisin konkurrencën e lirë mes operatorëve, sic përcakton edhe vendimi i GJED Çështja C-368/10 “Komisioni Europian vs. Mbretëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: “Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larinë e zgjidhjeve teknike.

Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”

Duke iu referuar një ndër qëllimeve kryesore të ligjit ku parashikohet se eficaenca, efikasiteti dhe mirëpërdorimi i fondeve publike, konkretisht neni 2, citoj:

Neni 2

Qëllimi

Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë eficaencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik.

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

janë postulate të padiskutueshme në referim të këtij ligji, Autoritetet Kontraktore duhet të mbajnë parasysh që të prokurojnë mallra shërbime punë në mënyrë sa më efikase duke përfituar një cmim sa më të ulët.

Dhe cmimet e ulta dhe konkruuese e bën një procedurë ku ofron shance të barabarta për të gjithë ofertuesit e mundshëm, pra duke mos aplikuar kriterë përjashtuese, kriterë që nuk kanë lidhje me objektin e procedurës së prokurimit dhe/ose kriterë që orientohen drejt një ofertuesi të caktuar apo një grupi ofertuesish, që automatikisht kufizon konkurrencën, rrjedhimisht duke bërë që të ofrohen

cmime më të larta.

Kjo sjellje bie ndesh edhe me legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH, konkretisht Ligjin Nr.9936, Datë 26.6.2008 Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ku parashikohet se institucionet duhet të kenë parasysh përdorimin eficient të fondeve publike, konkretisht neni 3 dhe neni 4 i ligjit, citoj:

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Buxhet” është tërësia e të ardhurave, shpenzimeve dhe financimeve të qeverisjes qendrore e vendore dhe të fondeve speciale, të cilat miratohen me ligj nga Kuvendi i Shqipërisë, më poshtë “Kuvendi” ose me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore.

Neni 4

Parimet e funksionimit të sistemit buxhetor

Parimet e funksionimit të sistemit buxhetor janë:

ç) përdorimi ekonomik, eficient dhe efektiv i burimeve publike;

ku përcaktimi në ligj është shterues që është detyrë kryesore e institucioneve mirëmenaxhimi i fondeve publike. Në këtë kuptim, AK, duke kufizuar konkurrencën, automatikisht keqmenaxhon edhe fondet publike.

Për të konkluduar QuantX IT Solutions shpk në vazhdim të arsytimit të paraqitur më lart, i gjykon më se të drejta e të ligjshme pretendimet e paraqitura.

Për sa kemi paraqitur më sipër, në dritën e fakteve, bazuar në legjislacionin përkatës, përfundimisht kërkojmë:

1. Pranimin e ankesës sonë.
2. Të pezullohet procedura e prokurimit deri në një sqarim përfundimtar të kërkesave për sqarim.
3. Të hiqet PIKA 2.3.6 tek Shtojta 7.
4. Modifikimin e dokumentave të tenderit.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme □

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

jo

7. Lista e informacionit konfidencial:

Informacione teknike, ekonomike, që nuk gjenden ne regjistra publike.

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

info@quantx.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Dorjana Mehmeti